


ADMINISTRATA DHE DINAMIKA SHOQËRORE E KULTURORE NË
VILAJETIN E KOSOVËS SIPAS DOKUMENTEVE OSMANE (SHEK. XIX –
FILLIMI I SHEK. XX)

TEMA PËR TITULLIN

MASTER I HISTORISË - KOHA E RE

NGA

ODESA XHEMAJLI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

FAKULTETI FILOZOFIK

DEPARTAMENTI I HISTORISË

PRISHTINË

KORRIK, 2026

REZYME E TEMËS SË DIPLOMËS

Mentori: Prof. Asoc. Dr. Selim Bezeraj

Kandidati: Odesa Xhemajli

Tema: Administrata dhe dinamika shoqërore e kulturore në Vilajetin e Kosovës sipas dokumenteve osmane (shek. XIX – fillimi i shek. XX)

Studimi i temës “Administrata dhe dinamika shoqërore e kulturore në Vilajetin e Kosovës sipas dokumenteve osmane (shek. XIX – fillimi i shek. XX)” synon të trajtojë organizimin administrativ, strukturën shoqërore, zhvillimin ekonomik, jetën arsimore, fetare dhe kulturore të Vilajetit të Kosovës gjatë periudhës së vonë osmane. Punimi mbështetet kryesisht në salnamet e Vilajetit të Kosovës, të cilat përbëjnë një ndër burimet më të rëndësishme për studimin e organizimit administrativ, institucioneve shtetërore, përbërjes demografike dhe zhvillimeve shoqërore e kulturore të kësaj province.

Gjatë formulimit të punimit kemi përdorur metoda analitike dhe krahasuese, të cilat kanë mundësuar shqyrtimin dhe krahasimin e të dhënave të nxjerra nga salnamet e Vilajetit të Kosovës, literatura përkatëse dhe revistat shkencore. Punimi është i strukturuar në katër kapituj, në të cilët shtjellohen aspektet kryesore të organizimit dhe jetës së Vilajetit të Kosovës.

Në kapitullin e parë trajtohet organizimi administrativ dhe institucional i Vilajetit të Kosovës. Fillimisht paraqitet sistemi administrativ osman dhe ndikimi i reformave të Tanzimatit në riorganizimin e administratës provinciale. Më tutje, analizohet procesi i formimit të Vilajetit të Kosovës, organizimi i tij territorial në sanxhaqe, kaza dhe nahije, si dhe funksionimi i institucioneve administrative, gjyqësore dhe ushtarake.

Në kapitullin e dytë shqyrtohet struktura demografike, urbane dhe shoqërore e Vilajetit të Kosovës. Nëpërmjet të dhënave statistikore të salnameve paraqitet përbërja demografike dhe fetare e popullsisë, shpërndarja e saj në sanxhaqe dhe qendra të ndryshme administrative, si dhe zhvillimi i qyteteve kryesore të vilajetit. Po ashtu trajtohen karakteristikat e jetës shoqërore, format tradicionale të organizimit të komuniteteve lokale dhe roli i qendrave urbane në zhvillimin ekonomik e shoqëror të provincës.

Në kapitullin e tretë trajtohen kushtet gjeografike, territoriale dhe zhvillimi ekonomik i Vilajetit të Kosovës. Në këtë pjesë paraqiten karakteristikat gjeografike të vilajetit, resurset

natyrore, zhvillimi i bujqësisë dhe blegtorisë, si dhe aktivitetet tregtare që zhvilloheshin në qendrat kryesore urbane. Gjithashtu trajtohet infrastruktura rrugore dhe hekurudhore, e cila ndikoi në zhvillimin ekonomik dhe në integrimin e vilajetit me pjesët e tjera të Perandorisë Osmane.

Në kapitullin e katërt trajtohen institucionet arsimore, fetare dhe jeta kulturore në Vilajetin e Kosovës. Në këtë kapitull paraqitet zhvillimi i arsimit dhe funksionimi i institucioneve arsimore osmane, roli i medreseve, shkollave dhe institucioneve fetare në jetën shoqërore, si dhe aktiviteti kulturor dhe intelektual në qytetet kryesore të vilajetit. Vëmendje e veçantë i kushtohet ndikimit të këtyre institucioneve në zhvillimin kulturor dhe arsimor të popullsisë.

Në fund të punimit paraqiten përfundimet kryesore të hulumtimit, në të cilat evidentohen veçoritë administrative, shoqërore, ekonomike dhe kulturore të Vilajetit të Kosovës.